



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr. 273

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj, Partisë Demokratike e Shqipërisë

Kërkues: Denoncues

Ndaj: Partisë Demokratike të Shqipërisë

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 78 pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:



Data: 21 Prill 2021
Nr. 273

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë

I

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një kallëzim në e-mail denoncime.kqz@gmail.com, nga një denoncues, për hapjen e zyrës elektorale nga ana e Partisë Demokratike të Shqipërisë pranë vendndodhjes së qendrave të votimit në kundërshtim me udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar pikës 4, të nenit 6, të vendimit nr. 9/2021 “Për procedurat e funksionimit dhe portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” parashikohet se:

“Denoncuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim, por denoncimi i tij do të pranohet për shqyrtim, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit, si dhe informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht, shkeljet e mundshme.”

Për sa më sipër, marrë në konsideratë faktin se në denoncimin e tij, denoncuesi në fjalë ka kërkuar të mbetet anonim duke dhënë dhe arsye objektive përse kërkon të mbetet i tillë, gjeneralitetet e tij, gjatë shqyrtimit të këtij denoncimi, do të mbeten anonim.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Referuar nenit 82 e vijues, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II

Rrethanat e faktit

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 09.03.2021 ka nxjerrë udhëzimin nr. 6 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Akte të KQZ” dhe kategorinë “Akte të Komisionerit”.

Në kallëzimin e raportuar më datë 04.04.2021, ora 20:44, protokolluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 3898 prot., datë 17.04.2021, pretendohet se: “Në zonën e Kodër Kamzës, pranë Qendrës së Votimit 2021/0 dhe 2021/1 (të cilat janë caktuar të kenë vendndodhje për zgjedhjet e 25 prillit 2021, në lokal Xhelal Bodini, rr. “Kastriotët”, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë”), Partia Demokratike e Shqipërisë ka hapur një zyrë elektorale që ndodhet shumë pranë vendndodhjes së qendrave të votimit, gjë e cila mund të ndikojë më datë 25.04.2021 duke intimiduar votuesit dhe ndikuar në mënyrë të pa drejtë dhe diskriminuese lidhur me preferencat e votuesit të cilat mund të jenë të lira”.

Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesi ka paraqitur aktin provues fotografi ku tregohet zyra elektorale e subjektit zgjedhor Partisa Demokratike e Shqipërisë dhe dy qendrat e votimit të kësaj zone.

Për sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, administrata e KQZ nëpërmjet e-mail-it të datës 19.04.2021, ka kërkuar kryerjen e verifikimeve të nevojshme në terren nëpërmjet personit të autorizuar nga KQZ.

Në datën 19.04.2021, ora 12:30, jemi informuar nga personi i autorizuar nga KQZ, se zyra elektorale objekt denoncimi, ndodhet në distancë më të vogël se 300 metra nga qendrat e votimit, në kundërshtim me parashikimet e udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

III



Analiza juridike dhe konkluzione

Në vlerësim të provave dhe fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhor çmon se:

Referuar nenit 5, të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikohet se:

“1. Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.

2. Subjekti zgjedhor njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vë në dijeni KQZnë për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Administrata e bashkisë përkatëse, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

4. Policia bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së.”

Për sa më sipër, në raportin e datës 19.04.2021, sjellë nga personi i autorizuar nga KQZ, për të kryer në terren verifikimin e fakteve të denoncuara nga denoncuesi, rezulton se:

Zyra zgjedhore e hapur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, në objektin privat lokal Xhelal Bodini, Rruga e Kastriotëve, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë, janë në shkelje të nenit 5 pika 1 të udhëzimit nr. 6/2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas raportimit, zyra zgjedhore është hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e QV-ve, pikërisht afër qendrave të votimit nr. 2021/2 dhe 2021/1.

Distanca e matur e zyrës zgjedhore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në objektin privat lokal Xhelal Bodini, Rruga Kastriotëve, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë, është afërsisht 150 metra larg Qendrës së Votimit.

Referuar nenit 5, pika 4, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, parashikohet se:

“Policia bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së.”

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 5, pika 4 të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021, të sipërcituar, konstaton se, mosmarrja e masave për mbylljen e zyrës zgjedhore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në Qarkun Tiranë ngarkon me përgjegjësi policinë bashkiake të Bashkisë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 78 pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Policia bashkiake të marrë masa të menjëhershme për të mbyllur zyrën zgjedhore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në Qarkun Tiranë.
2. Kryetari i Bashkisë Tiranë, të njoftojë menjëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

